



Republika e Kosovës – Republika Kosova  
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia  
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr.100/2016

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Dr. sc. Rafet Haxhaj kryesues, Fejzullah Rexhepi dhe Faton Ademi anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e Institutit Demokratik të Kosovës (KDI), Prishtinë, paraqitur kundër subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), dega në Drenas, për shkak të vendosjes së posterit në hapësirë publike për Zgjedhjet e Jashtëzakonshme për Kryetar të Komunës së Drenasit, në seancën e panelit të mbajtur me 03.12.2016, mori këtë:

### VENDIM

**Miratohet** si e bazuar ankesa e Institutit Demokratik të Kosovës (KDI), Prishtinë, Anr.100/2016 të datës 02.12.2016, kështu që subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), dega në Drenas, i shqiptohet dënimi më gjorbë në vlerë prej 1200 (njëmijë e dy qind) euro, të cilën detyrohet ta paguaj në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditë nga dita e pranimit të këtij vendimi.

### Arsyetim

PZAP-i, me datën 02.12.2016, ka pranuar një ankesë me numër Anr.100/2016, nga KDI, me të cilën pretendohet se më datë 01.12.2016, rreth orës 14:00 në Sheshin kryesor të qytetit, gjatë monitorimit të fushatës zgjedhore për Zgjedhjet e Jashtëzakonshme për Kryetar të Drenasit, kanë vërejtur një parregullësi nga ana e subjekti politik PDK, duke vendosur posterin e kandidatit të tyre për Kryetar Komune të Drenasit, në shtyllë publike.

Parashtruesi i ankesës thekson se në këtë rast subjekti politik PDK ka bërë shkeljen e nenit 33 paragrafi 1 pika b të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme Ligji Nr. 03/L-73. Lidhur me këtë rast parashtruesi i ankesës si dëshmi i ka bashkangjitur një fotografi dhe një CD në të cilën ishte një fotografi nga vendi i ngjarjes.

PZAP-i, në kuptim të nenit 6 paragrafi 6 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it, subjektin politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), e informoi lidhur me ankesën Anr.100/2016 të datës 02.12.2016, të parashtruar nga ana e KDI-së, dhe kërkoi që të përgjigjet ndaj kësaj ankese deri më datë 03.12.2016 në ora 12:00.

PZAP-i, pranoi përgjigjen e kërkuar nga subjekti politik PDK në të cilën konsiderojnë se janë të pabaza pretendimet e KDI-së lidhur me shkëljen e nenit 33 paragrafi 1 pika b e LZP-së. Sipas këtij neni të LZP-së thuhet pika b) vendosja e njoftimeve, pllakateve dhe posterëve, ose përndryshe vendosja e e emrave të tyre ose slloganeve në lidhje me fushatën zgjedhore brenda ose jashtë ndërtesave publike ose godinave, në apo mbi rrugë publike, në shenjat publike të trafikut, brenda ose jashtë hapësirave ose ndërtesave të zëna ose ndryshe, që shfrytëzohen nga organizatat ndërkombëtare, brenda ose në hapsirat private pa lejen e pronarëve ose shfrytëzuesve.

Më tej në përgjigjen në ankesë të subjektit politik PDK theksohet se në LZP neni 33 paragrafi 1 pika b nuk ceket se vendosja e posterave në shtyllë publike është shkëlje siç pretendon KDI dhe se nga “dëshmitë e ofruara në foto nuk mund të themi se kemi të bëjmë me një shtyllë publike”.

PDK në përgjigje në ankesë shtoi se në ankesën e KDI-së thuhet se posterit që është vendosur në sheshin kryesor të qytetit, por dëshmitë e ofruara mund të konfirmojn se fotografia është realizuar në rrugën “Shaban Shala” dhe se në këtë shtyllë sipas tyre nuk shifet asnjë poster. Më tutje subjekti politik PDK thekson se në qoftë se KDI-ja ofron dëshmi shtesë se kemi të bëjmë me shtyllë publike, PDK-ja është e gatshme të largojë posterin nga shtylla në fjalë.

PDK konsideron se nuk kanë prova konkrete nga KDI lidhur me cenimin e nenit 33 paragrafi 1 pika b të LZP-së, dhe kërkon nga PZAP-i që ta hedhë poshtë këtë pretendim të KDI-së.

PZAP-i, pasi që shqyrtoj ankesën gjeti se:

### **Ankesa është e bazuar**

Nga fotografitë e ofruara si provë të cilat gjenden në shkresat e lëndës shihet qartë se posterit i kandidatit për Kryetar të Komunës së Drenasit nga radhët e subjektit politik PDK- Ramiz Lladrovci, posterit i tij duket i vendosur në hapësirën publike, e që është në kundërshtim me nenin 33 pika b) të LZP-së e cila përcakton veprimet e ndaluara nga ana e subjekteve politike gjatë fushatës zgjedhore që ndalon vendosjen e pllakateve, posterave dhe njoftimeve në vende publike.

Për përcaktimin e lartësisë së gjobës të vendosur në dispozitiv të këtij vendimi PZAP-i, ka marrë parasysh faktorët në vijim:

- Natyra e shkëljes dhe ndikimit të mundshëm të saj në procesin zgjedhor;
- Shkallën dhe peshën e shkëljes;
- Nëse subjekti politik ka marrë pjesë në zgjedhjet e mëparshme, konsiderohet se kanë qenë të njoftuar me obligimet dhe përgjegjësit gjatë procesit të fushatës;
- Nëse subjekti politik ka bërë shkëlje të ligjeve zgjedhore në fuqi në këto zgjedhje apo në zgjedhjet e mëparshme në Kosovë si dhe

- Shumën e fondeve të marra nga subjekti politik prej Buxhetit të Republikës së Kosovës, për zhvillimin e aktiviteteve të lidhura me fushatën zgjedhore.

PZAP-i, mori parasysh të gjitha rrethanat si rëndësuese ashtu edhe rrethanat lehtësuese. Si rrethanë rëndësuese mori se subjekti politik PDK ka marrë pjesë edhe në zgjedhjet e kaluara dhe se është i njoftuar me rregullat zgjedhore, si dhe faktin se posteri i kandidatit për Kryetar Komune të Drenasit ka qenë i vendosur në vendin e palejuar për vendosjen e tyre.

Prandaj pretendimet e palës përgjegjëse nuk janë bërë të besueshme pasi i njëjti pretendim nuk është argumentuar apo aprovuar me anë të provave. Ndërsa si rrethanë lehtësuese PZAP-i mori se subjekti politik PDK, pas marrjes së kërkesës për përgjigje në ankesë nga PZAP-i, brenda afatit të caktuar, ka ofruar një fotografi si dëshmi në të cilën duket se ka ndërmarr veprime të dukshme për evitimin e shkeljes duke e larguar posterin nga vendi ku ka ndodhur shkelja dhe se hapësira publike është po e njëjta hapësirë për të cilën kishte bërë ankesë KDI.

Andaj PZAP-i duke marrë parasysh të gjitha arsyet e lartcekura se nga ana e subjektit politik PDK është shkelur neni 33 paragrafi 1 pika (b) të LZP-së, pasi që posteri e kandidatit për Kryetar Komune të saj ishte i vendosur në hapësirë publike, si dhe duke pasur parasysh se përgjigja në ankesë nga ana e PDK-së kishte të bashkangjitur një fotografi, ku shifet qartë se janë ndërmarr veprime për evitimin e shkeljes edhe pse në përgjigjen në ankesë nga subjekti politik PDK mohohet se ka ndodhur një shkelje e tillë.

PZAP-i në bazë të provës të cilën e ka ofruar të bashkangjitur në përgjigje në ankesë PDK ka caktuar lartësinë e gjobës së shqiptuar, dhe në kuptim të nenit 118.1 dhe 120 paragrafi 1 pika c të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

### **Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia**

Anr.100 /2016 më datën 03.12.2016.

**Kryesuesi i Panelit  
Dr.sc Rafet Haxhaj**

**Këshillë juridike:** Kundër këtij vendimi nuk lejohet ankesë konform nenit 118.4 të LZP-së.

